

Zyrës për Doktoraturë te Universitetit të Tetovës

Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e mbajtur më **24.12.2019** solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: **“Pozita e shqiptarëve në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1918-1941”** të kandidatit **Mr. Besnik Rameti**.

Në bazë të vendimit **16-113/7** të datës **24.12.2019**, Komision i përbërë nga: **Prof.dr. Zeqirja Idrizi** (kryetar), **Prof. dr. Fehari Ramadani**, **Prof.dr. Zeqirja Rexhepi**, **Prof.dr. Isak Sherifi** (anëtarë) dhe **Prof. dr. Nebi Dervishi** (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

## REFERAT

### Të dhëna biografike për kandidatin

Mr. Besnik Rameti, i lindur më 06.10.1982 në fshatin Raçe të Shkupit. Në vitin akademik 2001/2002 regjistroi studimet deridiplomike në drejtimin Histori në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, ku ka diplomuar me notë mesatare 9,50. Në vitin 2008/2009, regjistroi studimet pasdiplomikepoashtunë drejtimin Histori në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, te cilat i përfundoi me notë mesatare 9.00 dhe temë te magjistraturës “Shkupi me rrethinë gjatë sundimit të Mbretërisë Jugosllave 1929-1941”. Në vitin akademik 2016/2017, vazhdoi studimet e ciklit të tretë në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Filozofik, në drejtimin: Historinë e popullit shqiptar- peridhabashkëkohore. Nga shtatori i vitit 2009 deri në shtator të vitit 2018, ka punuar profesor në Gjimnazin “Zef Lush Marku” në Shkup si dhe mësimdhënës vullnetar në shkollën e mesme “Koço Racin” në Veles. Ka marrë pjesë në konferenca dhe simpoziume shkencore brenda dhe jashtë vendit. Nga shtatorim i vitit 2018, është punësuar si asistent i ri hulumtues në Insitutin për trashëgimi kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve- Shkup. Nga marsi i vitit 2019, është udhëheqës i departamentit të historisë në kuadër të ITKShSh-së. Është autor i një monografie të botuar dhe disa punimeve shkencore nga fusha e historisë.

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoraturës

Kandidati Besnik Rameti që nga fillimi studimeve të ciklit të tretë e deri më sot, ka treguar përparim të caktuar të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe punimin e temës. Kandidati me sukses ka realizuar tre konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Mr. Besnik Rameti gjatë studimeve të doktoraturës ka botuar një monografi dhe dy punime shkencore, që janë të lidhura drejtpërdrejt me temën e doktoraturës.

***Shkupi me rrethinë gjatë sundimit të Mbretërisë Jugosllave 1929-1941***, Shkup, 2017.

***Konventa Jugosllave –Turke***, në: Kërkime Historike , nr. 12, Shkup, 2018.

***Reformat agrare dhe kolonizuese në Shkup me rrethinë 1931-1935***, në: Studimet Albanologjike, nr.18, Shkup, 2018.

Analizë të punimit“Pozita e shqiptarëve në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1918-1941”

Punimi i disertacionit “*Pozita e shqiptarëve e Shkupit me rrethinë gjatë viteve 1918-1941*”, është ndarë, në: Parathënie, Hyrje, katër kapituj, Përfundimi, dy shtojca dhe Literaturën e shfrytëzuar.

Kapitulli i parë, ***Pozita e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë gjatë sundimit të Mbretërisë Serbe Kroate dhe Sllovene (SKS) 1918-1929***, është ndarë në tre nënkapituj: *Ndarja administrative dhe territoriale të shqiptarët në Shkup me rrethinë; Gjendja ekonomike e shqiptarëve në Shkup me rrethinë; Gjendja politike e shqiptarëve dhe aktiviteti politik i Xhemijetit në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1918-1929.*

Më 1 nëntor 1919, territori i “Serbisë së Vjetër” u nda në tre krahina, përkatësishtë në tre divizione ushtarake: të Kosovës, Manastirit dhe Vardarit. Kjo ndarje administrative – territorial qëndroj në fuqi deri në 28 qershor 1921, kur u miratua Kushtetuta e Vidovdanit, sipas së cilës Maqedonia e Vardarit ndahej në 7 qarqe. Në krye të krahinave qëndronin zhupanët, kurse në krye të rretheve qëndronin naçallnikët. Ndarja e trefishtë ushtarake-policore-civile, si dhe caktimi i kufijve vëndosej në atë pjesë ku popullsia e tyre ishte etnikisht e përzier, kishin për qëllim dobësimin e qëndresës së popullit shqiptar dhe të lehtësimin e serbizimit të këtyre trevave. Sipas hierarkisë qeverisëse, krahina e Maqedonisë së Vardarit në krye kishte Zhupanin e Madh, i cili emërohej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga mbreti. Zhupani përmes organeve shtetërore qeveriste me të gjitha punët administrative në krahinë.

Të gjitha viset e Shtetit SKS nuk kishin zhvillim të njëjtë ekonomik, Shkupi si qendër e Zonës së III ushtarake, ishte vend i prapambetur në pikëpamje ekonomike, me industri të pazhvilluar, ishte me karakter agrar bujqësor, me një teknikë mjaft të vjetëruar agrare. Kjo është si pasojë jo vetëm e politikës së padrejtë serbe por edhe shkatërrimeve nga luftërat ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore. Borgjezia serbe nuk ishte e interesuar për zhvillimin e industrisë kapitaliste. Me akte dhe dekrete të veçanta mohoheshin të drejtat elementare dhe individuale të shqiptarëve. Në Shkup dhe rajonet tjera përreth, zejtaria ishte degë e rëndësishme e ekonomisë. Zejtaret punonin me mjete primitive dhe nuk mund të konkuronin punëtorive të mëdha që punonin me mjete më të mira dhe me shumicë. Njëra nga shkaqet që Shkupi mbet me një ekonomi të pazhvilluar, sepse rrezikoheshin nga konkurrenca e prodhimeve industriale që vinin nga popujt tjerë të Mbretërisë SKS, që ishin me nivele më të larta zhvillimi.

Partitë dhe organizatat politike zhvillonin luftë politike njëra me tjetrën e sidomos Dinastia e Karagjergjoviqëve nëpërmjet Partisë Radikale, luftonte me tërë qenien e vet për të dominuar në mbarë jetën ekonomike dhe politike brenda shtetit. Pas Luftës së Parë Botërore, veprimtaria e partive politike serbe ka qenë shumë e gjerë, sidomos deri në vitin 1929. Popujt që nuk ishin konstitutiv në shtet, duhej të gjenin forma për formimin e partive politike, që të mund lirisht të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare, që të përgatiten drejt zgjidhjes së çështjeve të tyre nacionale dhe fetare.

Partia e Xhemijetit (Bashkimi) u themelua në Shkup më 18 dhjetor 1918, si parti politike shqiptare me Status dhe program të saj. Kryetar i këshillit qëndror ishte Nexhip Draga nga Mitrovica, nënkryetar Sheh Sabedini nga Tetova dhe sekretar Aqif Bluta nga Pazari i Ri. Tendenca që ajo quhet turke nuk është asgjë tjetër veçse nënçmim i lëvizjes çlirimtare shqiptare. Shumica e antarëve të Xhemijetit ishin shqiptarë. Programi i Xhemijetit prej dhjetë pikave, ishte një nga shtyllat kryesore të veprimit politik, arsimor dhe kulturor të myslimanëve nga trevat lindore, si një element kompakt dhe i organizuar në Mbretërinë SKS.

Shqiptarët u deshtë që t'u përgjigjen në mënyrë adekuate formave represive që ushtronte sistemi shtetëror: duke vepruar legalisht nëpërmjet Xhemijetit, duke rezistuar nëpërmjet çetave kaçake, dhe duke propaganduar çështjen shqiptare në arenën ndërkombëtare nëpërmjet Komitetit të Kosovës me seli në Shkodër. Lëvizja kaçake ka pasur çeta të armatosura edhe në rrethin e Shkupit nën udhëheqjen e Adem Bulkut, të cilat kanë qënë në kontak të përhershëm me lëvizjet kaçake të Kosovës dhe lëvizjen kaçake të Maqedonisë Perëndimore.

Kapitulli i dytë, *Pozita e shqiptarëve në Shkup me rrethinë gjatë Mbretërisë së Jugosllavisë (1929-1941)*, është ndarë në katër nënkapituj: *Ndarja administrative dhe territoriale dhe shqiptarët në Shkup me rrethinë; Gjendja ekonomike e shqiptarëve në Shkup me rrethinë; Pozita politike e shqiptarëve në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1929- 1941; Roli i Bashkësisë Fetare Islame 1929-1941.*

Situata politike në Mbretërinë SKS gjatë viteve 1918-1929 ishte shumë e paqëndrueshme. Mesatarisht në çdo pesë muaj ndërrohej një qeveri. Vetëm dy qeveri u shkarkuan si rezultat i humbjes së shumicës parlamentare, 22 qeveri u shkarkuan me dekrete mbretërore të mbretit Aleksandër Karagjergjeviç. I ndodhur në këto kushte dhe duke shfrytëzuar ndikimin e madh që kishte në ushtri, mbreti organizoi grusht-shtet, duke e rrëzuar qeverinë dhe duke vendosur të ashtuquajturën Diktaturë e 6 janarit 1929. Tashmë shteti e ndërroi edhe emrin dhe u quajt Mbretëria e Jugosllavisë. Me themelimin e Mbretërisë Jugosllave, shteti u nda në 9 banovina, kurse banovinat në rrethe dhe komuna Në krye të Banovinës së Vardarit me qendër në Shkup, u emërua bani Zhika Llaziq, i cili me origjinë ishte na qarku i Tetovës.

Nga viti 1930, filloi ndërrimi i toponimeve të vendbanimeve fshatave, të selive të komunave dhe më gjerë, duke e paraqitur çdo veprim të tyre, si dëshirë e popullit. Rëndësia historiografike e emërtimeve të reja synonte zhdukjen e emrave të lashtë të toponimisë shqipe. Procesi i ri emërtimeve dhe i emërtimeve kishte rrugën e tij normative-ligjore.

Mbretërinë e Jugosllavisë karakterizonte zhvillim jo të barabartë ekonomik në të gjitha krahinat, posaçërisht për vendet jugore nën të. Banovina e Vardarit ishte vend i prapambetur në pikëpamje ekonomike, edhe pse ishte, vend agrar, ngjajshëm karakterizohej Kosova dhe Maqedonia. Borgjezia serbe nuk mbante llogari për problemet sociale, as për zgjidhjen e kësaj çështjeje por në mënyrë të pa ligjshme pasurohej në llogari të saj duke shfrytëzuar djersën dhe vobektësinë e masave të gjëra popullore.

Bujqësia, në kontinuitet, mbeti veprimtaria kryesore ekonomike e popullsisë në Banovinën e Vardarit edhe pse ajo ishte dega kryesore, teknika e punës ishte e vjetëruar. Situatën ekonomike, e keqësonte më shumë situata e vështirë politike, pa kujdesia e shtetit ndaj prodhuesve bujqësor, mbjellja e prodhimeve pa planifikim, pasiviteti ekonomik, obligimet e tepruara pa kontroll, ndaj të dhënave fshatare (taksa-paguese). Qarqet sunduese të borgjezisë serbomadhe, ishin të vetëdijshëm, se eliminimi i kushteve materiale të jetesës, përmes politikës së diskriminimit ekonomik, ishte mënyra më e përsosur e presionit ndaj masave shqiptare.

Mbreti Aleksandër, bëri grusht shtet, më 6 janar 1929 anuloi Kushtetutën e vitit 1921, shpërndau Kuvendin Popullor, dhe Mbreti u bë pushtetmbajtës kryesor, duke zbatuar ekzekutivin diktatorial. Ekzekutivi i tij në histori, njihet si periudha më e vështirë për popullatën shqiptare të Shkupit me rrethinë, atë vit, partitë e hegjemonisë serbe, si Partia Radikale, Partia Demokratike, të cilat shprehnin qartë idenë për krijimin e Serbisë së Madhe. Kryetarët e qeverive, u munduan të shfaqen si luftëtar i idesë së Jugosllavizmit integral, dhe i unitarizmit nacional, mbrojtës i centralizmit shtetëror, në favor të popullit serb.

Pas formimit të Mbretërisë SKS për myslimanët do të filloj një periudhë e vështirë, periudhë kjo e cila për Bashkësinë Islame sipas disave mendohet periudha më e vështirë e organizimit të jetës fetare dhe myslimanëve. Në këtë periudhë do të vinë në shprehje një numër i madh i dobësive organizative të cilat do të vështirësojnë jetën fetare të myslimanëve në këto troje. Pas ndryshimeve politike dhe formimit të Mbretërisë së Jugosllavisëdo të filloj një organizim i ri, do të bëhet unifikimin e të gjitha ligjeve, në mesin e të cilëve edhe Ligjin për Bashkësinë Fetare Islame, i cili u miratua më 31 Janar të viti 1930.

Kapitulli i tretë, ***Reformat agrare dhe kolonizuese dhe pozita e shqiptarëve në Shkup me rrethinë***, është ndarë në tre nënkapituj: *Reformat agrare dhe kolonizuese gjatë viteve 1918-1929; Reformat agrare dhe kolonizuese gjatë viteve 1929-1941; Konventa jugosllavo-turke.*

Pas Luftës së Parë Botërore shqiptarët e Shkupit me rrethinë humbën çdo prespektivë ekonomike dhe politike, menjëherë filloj shpërngulja e tyre me plane të caktuara nga ana e pushtetit të ri serb, me qëllim që ti sllavizoj qytetin e Shkupit me rrethinë. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, vazhdoi procesi i kolonizimit në trevat lindore.

Në fillim të vitit 1919, kolonizimi u zbatua pa asnjë koordinim, dhe nuk u udhëhoq si duhet nga ana e institucioneve shtetërore. Pushteti, kolonët i vendoste në shtëpitë e fshatarëve vendas shqiptarë dhe të atyre të shpërngulur. Kolonëve, përveç tokës së dhënë falas, pushteti disave ua ndërtonte edhe shtëpitë, si dhe u jepte material ndërtimor, kredi, i lironte nga tatimet shtetërore dhe komunale, kurse të drejtën e plotë si pronarë do ta mernin pas 10 vjetësh.

Puna e parë e organizuar për zbatimin e Reformës agrare filloi me themelimin e Drejtorisë Agrare në Shkup, më 12 shkurtit 1920. Për të zbatuar kolonizimin me sukses, Ministria e Reformës agrare e kishte të angazhuar edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, që të intervenojnë menjëherë në raste të çregullimeve. Mënyra e kolonizimit në këto treva ishte specifike dhe ndryshonte nga pjesët tjera të Mbretërisë SKS.

Me proklamimin e reformës agrare, edhe bashkësitë fetare si zotëruese të pronave të mëdha duhej të viheshin në shërbim të zbatimit të kësaj reforme. Në këtë drejtim, Kisha Ortodokse Serbe, ishte e privilegjuar, dhe ajo u vu në shërbim të kolonizimit të trevave lindore. Qarqet sunduese, filluan ta hedhin poshtë kolonizimin si mjet të tyre, dhe përqafojnë energjikisht shpërnguljen me masë të shqiptarëve. Shqiptarët duhej të asimiloheshin, të shkombëtarizoheshin dhe të shndërroheshin në pakicë.

Zbatimi i reformës agrare ishte vënë nga ana e pushtetit si “qëllim nacional” për kolonizimin dhe serbizimin e territoreve të trevave shqiptare. Ky synim shtetëror për kolonizim ishte inkorporuar edhe në programet e partive udhëheqëse. Politika e këtyre agrare në Kosovë dhe Maqedoni kishte, kryesisht, dy qëllime, shkombëtarizimin e popullsisë shqiptare dhe krijimin e hendekut në mes të saj e kolonistëve. Borgjezia serbe shpresonte se në këtë mënyrë do t’i siguronte pozitat e saj ekonomike, shoqërore e politike. Në disa raporte të vitit 1938, “ngritja ideore dhe politike e shqiptarëve”, prej nga buronte edhe “rezistenca ndaj shpërnguljes dhe kolonizimit”, u vlerësua si rrezik i madh, për të ardhmen në rast të një konflikt ndërkombëtar.”

Gjatë viteve 1936-1938, hovshëm, dhe me shumicë, filloi procesi i shpërnguljes së shqiptarëve duke i realizuar të gjitha projektet që dirigjoheshin nga Beogradi, po këtë gjendje të vështirë, e përjetoi më së shumti Kosova, me seli në Shkup, këtë gjendje të vështirë, e përjetoi rrethina e tij. Gjatë qeverive të Millan Stojadinoviçit dhe Cvetkoviç-Maçekut, shqiptarët ishin në gjendje shumë të vështirë si në pikëpamje ekonomike, politike e sociale. Platforma më e rëndë për zhdukjen e shqiptarëve ishte e akademikut Vaso Çubriloviç.

Me formimin e Qeverisë së Millan Stojadinoviçit, filluan konsultimet intensive, lidhur me shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Në Ankara u mbajt një Mbledhje ndërministrorë e Këshillit të vendeve ballkanike, e ashtuquajtur “Për marrëveshje”, më 25-27 shkurt 1938. Në këtë takim përveç tjerave, ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë doli me propozim për shpërnguljen e myslimanëve të vendeve ballkanike në Turqi. Këtë propozim, Qeveria jugosllave e priti me pa durim, duke marrë masa përgatitore, që të filloj sa më parë. Në bazë të kësaj konvente shpërngulja do zgjaste 6 vjet, nga 1 korrikut 1939 deri në fund të vitit 1944. Për shpërnguljen e shqiptarëve, Komanda e III-të, doli me propozim se: “Së pari të shpërngulen shqiptarët e banuar nëpër vendet kufitare, e mandej ato në brendi, e së fundmi të shpërngulen turqit”.

Kapitulli i katërt, *Organizimi i jetës arsimore dhe kulturore të shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë gjatë viteve 1918-1941*, ka vetëm një nënkapitull: *Arsimi i shqiptarëve në Shkup mre rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore*.

Kur pushteti serb i përforcoi pozitat e veta, nuk mundi ta fshehë politikën e tij okupuese, duke përdorë metoda më barbare, por një shtet që kujdesej për ta ngritur kulturën dhe arsimin. Politika arsimore e asaj kohe ishte më tepër preokupim i pushtetit ushtarako-policor sesa politikë shtetërore-arsimore. Pasi e analizuan situatën, ata filluan të sjellin mësues në trojet shqiptare. Ardhja e këtyre mësuesve nuk u prit mirë nga popullata. Këtu kishin rol imamët, si njerëz që e mbanin gjallë jetën fetare dhe njerëz që e udhëhiqnin popullin dhe të cilëve populli u besonte.

“Hapja e shkollave fillore për pakicat kombëtare”, e cila ishte parashikuar në nenin 16 të Kushtetutës së Vidovdanit, ngeli vetëm një akt në letër dhe kurrë nuk u zbatua, veçanërisht për shqiptarët. Në dokumentet dhe në shtypin e kohës është pasqyruar në mënyrë të gjërë e të qartë politika antishqiptare në fushën e arsimit, qëndrimet e tyre kundër mësimit e shkollës shqipe. Ministria e Arsimit, në Mbretërinë serbe-kroate-sllovene, filloi të hapte shkolla në gjuhën serbo-kroate, sidomos në Shkup, ku u hapën këto shkolla fillore, shkolla të ulëta profesionale, gjimnaze, shkolla fetare, shkolla e larta. Në vitin 1919, Ministrisë së Arsimit në qeverinë e Mbretërisë SKS-ë nga Xhemijeti (Bashkimi), në formë të rregullt iu shtrua kërkesa për hapjen e shkollave për fëmijët e konfesionit mysiman në gjuhën e tyre amtare.

Meqë gjatë viteve 1918–1929 Mbretëria e SKS nuk kishte sukses për hapjen e shkollave shtetërore, atëherë u drejtua kah arsimi fetar, ky lloj arsimi ishte në vullnetin e popullatës myslimane, nga njëra anë, kurse nga ana tjetër institucionet fetare ishin nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Arsimit. Ulema Mexhlisi i Shkupit, përgatiste planprogramin për lëndën e mësimit, emëronte nëpunës fetarë, por edhe do të ushtronte pushtet disiplinor mbi ta.

Në rrethin e Shkupit ato ishin ndër më të përhapurat, saqë nuk kishte lagje në qytet ose në fshat që nuk kishte së paku një sibjan-mejtepe. Ato janë të vjetra sa edhe xhamitë. Shpesh në llojin e mejtepeve themelore gjendej edhe sibjan-mejtepi, përkatësisht shkolla fillore dominonte fetare, të cilat më së shumti hapeshin në fshatra, ku nuk kishte kushte për hapjen e shkollave të tjera në nivel më të lartë, si mejtep-ibtidaij ose medrese. Pushteti serb nuk ishte i qetë, sepse qarqet qeveritare dyshonin dhe herë-herë e pengonin me të madhe veprimtarinë e këtyre shkollave nën dyshimin se edhe në këto shkolla po zgjohej vetëdija kombëtare, ndërsa mësuesit e tyre cilësoheshin si njerëz shumë të rrezikshëm.

### Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura

Gjatë hartimit të këtij punimi të doktoraturës me titull *Pozita e shqiptarëve në Shkupit me rrethinë gjatë viteve 1919-1941*, kandidati është mbështetur në teorinë shkencore dhe metodologjinë e punës kërkimore-shkencore. Janë shfrytëzuar disa metoda shkencore, si analiza, sinteza, krahasimi dhe kriticizmi. Ndërsa metoda përshkruese për shkak të natyrës së punimit do të gjejë zbatim me të gjerë. Pasi tema është e kufizuar në periudhë kohore (1919-1941) dhe hapësirë të caktuar gjeografike, ndarja e saj do të jetë tematike.

Kandidati për përgatitjen e punimit ka shfrytëzuar burime arkivore të botuara dhe të pabotuara, gazetata zyrtare të Mbretërisë SKS dhe Mbretërisë së Jugosllavisë, shtypin ditor të kohës, punime shkencore nga revista të ndryshme, monografi, literaturë të përgjithshme në gjuhën shqipe, serbe, maqedone.

### Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Tema e doktoraturës “*Pozita e shqiptarëve e Shkupit me rrethinë gjatë viteve 1918-1941*”, është një përpjekje për të pasqyruar njëri nga periudhat më të vështira të shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë, sundimin e Mbretërisë Jugosllave. Politika shkombëtarizuese, Reforma agrare, shpërnguljet masive drejt Turqisë, dhuna dhe diskriminimi në të gjitha fushat e jetës janë ngjarjet që kanë përshkruar këtë periudhë. Shkupi në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore ka qenë qendra më e rëndësishme politike, ekonomike, arsimore dhe kulturore e shqiptarëve që jetonin në territoret e ish vilajetit të Kosovës. Për këtë shkak, që nga ditët e para të okupimit serb gjatë luftërave ballkanike deri në rënien e Mbretërisë së Jugosllavisë ndaj qytetit të Shkupit dhe çdo elementi shqiptar brënda dhe jashtë tij, është ushtruar presion dhe dhunë e tmerrshme.

Si përfundim, kandidati Mr. Besnik Rameti vlerëson se Mbretëria Serbe-Kroate-Sllovene (1918-1929) dhe Mbretëria e Jugosllavisë (1929-1941), gjatë sundimit të tyre u përpoqen të ndërrojnë strukturën etnike të popullsisë në trojet shqiptare. Për të arritur këto synime dhe për t'i justifikuar ato nga pikëpamja formale juridike përpara opinionit të huaj, ajo nxori edhe legjislacionin agraro-kolonizues. Udhëheqësit e borgjezisë serbe nuk kanë qenë të kënaqur me të arriturat e kolonizimit, respektivisht me ndërrimin e strukturës së popullsisë në disfavor të shqiptarëve, prandaj zgjidhja e vetme ishte shpërngulja masive e shqiptarëve në Turqi.



### Kontributet kryesore shkencore të kandidatit

Disa nga tematikat e kësaj teme mund të jenë trajtuar nga studiues në punime shkencore të ndryshme, por rëndësia e këtij disertacioni është trajtimi i shumë çështjeve të një periudhe të shkurtër, të një territori të caktuar brenda një teme të veçantë. Përmes shfrytëzimit të dokumentacionit dhe literaturës relevante dhe të pasur, do të sjellim fakte dhe njohuri të reja, të cilat janë një kontribut sa modest, po aq i çmuar për historiografinë shqiptare.

Rëndësi të veçantë nga të gjitha çështjet dhe problemet me të cilat janë përballur shqiptarët gjatë kësaj periudhe do ti kushtohet politikës shtetërore të drejtuar nga qarqet serbomëdha për spastrimin etnik të shqiptarëve nga Shkupi me rrethinë përmes Reformës agrare, marrëveshjeve për shpërngulje të muslimanëve në Turqi, dhe forma të presionit dhe dhunës sistematike nga regjimi jugosllav.

Këtyre çështjeve dhe problemeve kandidati ju është qasur nga një këndvështrim ndryshe, gjithnjë duke u munduar që të jetë sa më objektiv dhe për këtë është munduar ta bëjë përmes faktografisë shkencore. Vlerësojmë se kjo temë e disertacionit paraqet një kontribut për zbardhjen e një pjesë të historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe të historisë apostafat, historisë së Shkupit me rrethinë.

### Hulumtime të mundshme të ardhshme

Tema e doktoraturës “*Pozita e shqiptarëve e Shkupit me rrethinë gjatë viteve 1918-1941*”, është temë e përgjithshme dhe brenda saaj janë trajtuar tematika të ndryshme, kjo krijon mundësi për të qënë një bazë e mirë për hulumtime të ardhshme, sidomos për jetën ekonomike dhe shoqërore të shqiptarëve në Shkup me rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore.

Kandidati është munduar që për të gjitha fushat e jetës të shqiptarëve në Shkup me rrethinë të jap nga një pasqyrë të shkurtër, por kryesisht është ndalur në pozitën politike, reformën agrare e kolonizuese dhe shpërnguljen e shqiptarëve, me çrast ka arritur jo vetëm që të thelloj njohuritë e mëparshme të historiografisë shqiptare por edhe të ofroj njohuri të reja.

### Vlerësim dhe rekomandim

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoraturë “**Pozita e shqiptarëve në Shkup me rrethinë gjatë viteve 1918-1941**” të kandidatit **Mr. Besnik Rameti**, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor –Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

#### Komisioni recenzues:


1. Prof. Dr. Zeqirja Idrizi (Kryetar)

2. Prof. Dr. Fehari Ramadani (anëtar)

3. Prof. Dr. Zeqirja Rexhepi (anëtar)

4. Prof. Dr. Isak Sherifi (anëtar)

5. Prof. Dr. Nebi Dervishi (Mentor)



The image shows five handwritten signatures in blue ink, each written over a horizontal line. The signatures correspond to the names listed in the list above. The first signature is the most prominent and appears to be 'Zeqirja Idrizi'. The other signatures are less legible but appear to be 'Fehari Ramadani', 'Zeqirja Rexhepi', 'Isak Sherifi', and 'Nebi Dervishi'.

Tetovë, 06.04.2020.